ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Sipas vendimit të Këshillit Drejtues të datës 12/10/2022, Oda e Avokatëve të Kosovës ri shpallë:

K O N K U R S

- për vend të lirë të punës -

Duke i bërë publike dhe të arritshme për të gjithë:

I. Vendi i punës:

Zyrtar/e për IT & Administrator/e i Zyrës për caktimin e avokatëve Ex-officio;

II. Kushtet:

Përveç kushteve të përgjithshme ligjore për themelimin e marrëdhënies së punës, kandidati duhet t'i plotësojë edhe këto kushte, në lidhje me kualifikimet:

- Fakultetin juridik ose Fakultetin e Shkencave Kompjuterike
- 1 vit përvojë pune në lëminë kompjuterike
- njohja e punës në kompjuter (Programet e Windows-it) e obligueshme
- njohja gjuhës zyrtare në Kosovë (njohja e gjuhës angleze do të ishte e preferueshme)

III. Përshkrimi i punëve:

Administratori i zyrës ex-officio përveç tjerash kryen këto punë dhe detyra të punës:

- Njohuri elementare për Instalim, mirëmbajtje dhe konfirgurimi i pajisjeve kompjuterike, softuerëve, sistemeve, rrjeteve;
- Pranimin e kërkesave nga policia, prokuroria, gjykata, agjensioni i ndihmës juridike falas dhe agjensioni për mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave gjatë 24 orëve (përmes telefonit) shtatë ditë në javë, për caktimin e avokateve ex- officio;
- Plotësimin formave për caktimin e avokateve ex-officio dhe pro-bono;
- Ofrimi i mbështetjes teknike lidhur me sistemet dhe rrjetet kompjuterike;
- Instalimin, konfirgurimin, lidhjet diagostifikimin e problemeve dhe punët tjera që lidhet me funksionimin e sistemit kompjuterik brenda OAK-së;

- Identifikimin e zyrtarëve policor, gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të cilët shkelin rregullat caktimit të avokateve ex-officio dhe informimin e ZPD për ndërmarrjen e veprimeve të mëtutjeshme;
- Kontrollon rregullsinë e faturave dhe përgatitë vërtetimet për pagesë;
- Plotësimin e databazës me detajet e avokatëve të caktuar ex-officio apo pro-bono sipas kërkesave të institucioneve relevante;
- Realizimi i detyrave tjera qe dalin nga rregullorja për caktimin e avokatëve ex-officio; dhe
- kryen punët tjera sipas kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv;

Te kandidatët do të vlerësohen edhe: kreativiteti, shkathtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

IV. Paga:

Koeficienti i pagës: 5.5

V. Dokumentacioni dhe procesi i përzgjedhjes:

Kandidatët të cilët dëshirojnë të paraqiten në konkurs, duhet të sjellin këto dokumente:

- Aplikacionin (i cili plotësohet në OAK me rastin e dorëzimit të dokumenteve);
- Diplomën dhe dokumentet e tjera që dëshmojnë kualifikimet profesionale;
- Dëshmi të përvojës së punës;
- Vërtetimin qe nuk janë nen hetime;
- Letër-motivuese të shkurtër (prej rreth 1 faqe)

Kandidatët e zgjedhur për intervistë do të informohen për datën dhe vendin e mbajtjes së intervistës nga OAK.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, Rr. Bekim Fehmiu pn. (Ndërtesa Arting), Kati IV.

VI. Afati i Konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim, sikur edhe ata kandidatë të cilët nuk i përgjigjen ftesës për intervistim dhe nuk i nënshtrohen procesit të përzgjedhjes.

Informatat:

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të lajmërohen në: 038/244-586 dhe e-mail: info@oak-ks.org